

STATUT
I
KOMITETIT OLIMPIK KOMBËTAR SHQIPTAR

Miratuar në Tiranë, në datë 2 Dhjetor 2023

Asambleja e Përgjithshme e KOKSH

Fidel Tili
[Signature]



[Signature]

TABELA E PËRMBAJTJES

KREU I	HYRJE DHEDISA PËRKUFIZIME.....	4
Neni 1	Hyrje dhe Historik i Shkurtër	4
Neni 2	Disa Shkurtime/Përkufizime	4
KREU II	EMËRTIMI,KOHËZGJATJA, SELIA, MISIONI DHE ROLI.....	5
Neni 3	Emërtimi	5
Neni 4	Kohëzgjatja.....	5
Neni 5	Selia	6
Neni 6	Misioni dhe Roli	6
Neni 7	Detyrat dhe kompetencat e KOKSH-it.....	7
KREU III	EMBLEMA, FLAMURI DHE HIMNI	8
Neni 8	Emblema.....	8
Neni 9	Flamuri	8
KREU IV	PËRBËRJA DHE ANËTARËSIMI.....	8
Neni 10	Përbërja.....	8
Neni 11	Anëtarësimi	9
Neni 12	Kriteret Bazë për Anëtarësimin apo Përfaqësimin në KOKSH	10
Neni 13	Humbja e anëtarësisë.....	11
Neni 14	Masat dhe Sanksionet.....	11
KREU V	ORGANET E KOKSH-it.....	12
Neni 15	Organet e KOKSH-it	12
Neni 16	Asambleja e Përgjithshme	12
Neni 17	Asambleja e Përgjithshme Zgjedhore.....	15
Neni 18	Asambleja e Përgjithshme e Jashtëzakonshme	17
Neni 19	Votat në Asamblenë e Përgjithshme	18
Neni 20	Dërgimi i Vendimeve të AP-së tek Anëtarët.....	19
Neni 21	Komiteti Ekzekutiv.....	19
Neni 22	Presidenti	22
Neni 23	Zv.Presidenti.....	23
Neni 24	Mbajtësi i Thesarit.....	23
Neni 25	Sekretari i Përgjithshëm	23
Neni 26	Komisioni i Verifikimeve dhe i Etikës.....	24
Neni 27	Ndalimi i konfliktit të interesave	26
Neni 28	Mbledhjet në Kushtet e Forcës Madhore	26

KREU VI TË NDRYSHME	27
Neni 29 Burimet e financimit.....	27
Neni 30 Statuti dhe Rregullorja e Brendshme e KOKSH-it	27
Neni 31 Ndryshimet e Statutit.....	28
Neni 32 Akademia Olimpik Shqiptare	28
Neni 33 Këshilli i Arbitrazhit Sportiv.....	28
Neni 34 Baza ligjore.....	28



KREU I
HYRJE DHEDISA PËRKUFIZIME

Neni 1 Hyrje dhe Historik i Shkurtër

1. Ky statut (në vijim “**Statuti**”) është dokumenti themelor që sanksionon parimet dhe rregullat e organizimit dhe të funksionimit të Komitetit Olimpik Kombëtar Shqiptar.
2. Komiteti Olimpik Kombëtar Shqiptar është themeluar në vitin 1958 dhe është njohur nga Komiteti Olimpik Ndërkombëtar në vitin 1959.
3. Gjatë viteve 1958 - 1989 Komiteti Olimpik Kombëtar Shqiptar ka funksionuar nën emrin “*Komiteti i Këshillit të Përgjithshëm të BFSSH*” (Bashkimi i Fiskulturistëve dhe i Sportistëve të Shqipërisë), i cili përmblihte në vetvete të gjitha Federatat Kombëtare Sportive. Vetëm në arenën ndërkombëtare ai vepronte si Komitet Olimpik Kombëtar Shqiptar.
4. Me ndryshimin e sistemit politik në Shqipëri, pas vitit 1990, u nda Lëvizja Olimpike nga struktura shtetërore dhe u krijua Ministria e Kulturës, Rinisë e Sporteve dhe Komiteti Olimpik Kombëtar Shqiptar. Ky ndryshim u sanksionua me vendimin e Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë Nr. 255, datë 5.6.1992.
5. Me vendimet Nr. 20, datë 24.01.1994 dhe nr. 401, datë 22.8.1994 të Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë është sanksionuar ekzistenca e Komitetit Olimpik Kombëtar Shqiptar si organizatë jositetërore e jofitimprurëse dhe funksionimi i tij mbështetur në KO.
6. Në përputhje me kërkesat e Legjislacionit Shqiptar KOKSH është regjistruar në Regjistrin e Shoqatave Jofitimprurëse me vendimin Nr. 5934, datë 22.6.2018 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.
7. Lëvizja Olimpike në Shqipëri drejtohet dhe administrohet nga Komiteti Olimpik Kombëtar Shqiptar.

Neni 2 Disa Shkurtime/Përkufizime

1. “**AP**” është Asambleja e Përgjithshme e KOKSH.
2. “**Federata Sportive**”, “**Organizata Sportive**”, “**Shoqata Sportive**”, “**Shoqëri Sportive**”, “**Klube Sportive**”, “**Veprimtari Sportive**” kanë kuptimin e dhënë në Ligjin për Sportin.
3. “**Federata Olimpike**”, “**Federata Jo-Olimpike**”, “**Shoqata Olimpike**”, “**Organizata Sportive Olimpike**”, “**Shoqata Jo-Olimpike**”, “**Organizata Sportive Jo-Olimpike**” kanë kuptimin e dhënë të Neni 10 (*Përbërja*) i këtij Statuti.
4. “**Figurë e Pastër Morale**” do të thotë që personi në gjykimin e KVE ka një reputacion shoqëror dhe moral të pacënuar, nuk është dënuar për vepra të rënda penale nga organet kompetente shqiptare apo të huaja, nuk është dënuar nga organizata sportive për thyerje disipline, përdorim dopingu apo për abuzime financiare dhe që përfshirja e tij në KOKSH nuk do cënonte reputacionin e KOKSH.
5. “**Forca Madhore**” ka kuptimin që i jepet të Neni 28 (*Mbledhjet në Kushtet e Forcës Madhore*) i këtij Statuti.

6. “KAS” është Këshilli i Arbitrazhit Sportiv.
7. “KE” është Komiteti Ekzekutiv i KOKSH.
8. “KO” është Karta Olimpikë.
9. “KOKSH” është Komiteti Olimpik Kombëtar Shqiptar.
10. “KOR” është Komitetet Olimpikë Rajonale” .
11. “KON” është Komiteti Olimpik Ndërkombëtar.
12. “KVE” është Komisioni i Verifikimeve dhe Etikës.
13. “Legjislacioni Shqiptar” ka kuptimin e Ligjit për Sportin si dhe çdo ligji apo akti nënligjor, akti normativ kombëtar apo lokal, urdhri, dekreti apo akti tjetër, kodi, direktive, vendimi dhe akti të ministrave, qarkoreje të departamenteve, rregulloreje, deklarate dhe interpretimi të organeve zyrtare të Republikës së Shqipërisë, përfshirë ndryshimet e herëpashershme të tyre.
14. “Ligji për Sportin” do të thotë Ligji Nr. 79/2017 “Për Sportin”, i ndryshuar apo si mund të ndryshohet në të ardhmen.
15. “Olimpizmi” ka kuptimin që i jepet te KO.
16. “Vendime Qarkulluese” janë vendime që mund të aplikohen nga KE dhe Anëtarët e KOKSH për raste pandemie apo force madhore , apo kur kërkohet vendimarrje e shpejte, duke ushtruar të drejtën e votës të shprehur me shkrim dhe kërkojnë miratimin e më shumë se 50% të anëtarësisë.
17. “KPKSH” është Komiteti Paralimpik Kombëtar Shqiptar, i cili është Organizata e vetme e pavarur sportive që bashkon të gjitha shoqatat dhe organizatat sportive të personave me aftësi të kufizuara. KPKSH operon sipas statutit të saj, i cili duhet të jetë në përputhje me parimet e Lëvizjes Olimpikë dhe rregullat e Komitetit Ndërkombëtar Paralimpik (IPC) dhe duhet të miratohet nga IPC.

KREU II

EMËRTIMI, KOHËZGJATJA, SELIA, MISIONI DHE ROLI

Neni 3 Emërtimi

1. KOKSH është organizatë sportive kombëtare që drejton Lëvizjen Olimpikë në Shqipëri, e pavarur, jo shtetërore, pa qëllim fitimi, e organizuar në formën e shoqatës dhe që funksionon bazuar në parimet e KO, të Legjislacionit Shqiptar në fuqi dhe të këtij Statuti.
2. KOKSH është organizata e vetme që përfaqëson Lëvizjen Olimpikë Shqiptare, parimet e së cilës janë të detyrueshme për t'u zbatuar nga të gjithë anëtarët e saj.

Neni 4 Kohëzgjatja

Kohëzgjatja e KOKSH-it është e pakufizuar.

Neni 5 Selia

Selia e KOKSH-it është në adresën Rr. "Liman Kaba", Parku Olimpik, 1001, Tiranë. Ajo mund të ndryshohet nga Asambleja e Përgjithshme me propozim të Komitetit Ekzekutiv të KOKSH-it.

Neni 6 Misioni dhe Roli

1. Misioni i KOKSH-it është të zhvillojë, promovojë dhe të mbrojë Lëvizjen Olimpike në Shqipëri në përputhje me KO.
2. Roli i KOKSH-it është:
 - a) të promovojë parimet themelore dhe vlerat e Olimpizmit në Shqipëri në fushën e sportit dhe të edukimit sportiv, duke organizuar programe edukimi në të gjitha nivelet e shkollave, instituteve të edukimit fizik dhe universiteteve, si dhe duke inkurajuar, menaxhuar dhe/ ose administruar krijimin e instituteve të dedikuara edukimit Olimpik, të tilla si Akademia Olimpikë Kombëtare, Muzeu Olimpik, një ose më shumë Qendra Olimpikë dhe programe ose Institucione Kulturore të lidhura me Lëvizjen Olimpikë;
 - b) të sigurojë respektimin dhe zbatimin e KO në të gjithë vendin dhe të kërkojë respektimin e rregullave që drejtojnë sportet olimpikë, siç janë përcaktuar nga KON;
 - c) të inkurajojë zhvillimin e performancës së lartë në sport si dhe sportin për të gjithë;
 - d) të organizojë dhe të marrë pjesë në formimin e kuadrove drejtues, zyrtarëve dhe teknikienëve të Organizatave Sportive, duke organizuar kurse e duke siguruar që këto kurse të kontribuojnë në promovimin e parimeve themelore të Olimpizmit;
 - e) të luftojë ndaj çdo forme diskriminimi dhe dhune në sport;
 - f) të miratojë dhe të zbatojë Kodin Botëror Anti-Doping në përputhje me Legjislacionin Shqiptar dhe të kontribuojë në parandalimin e dopingut në sport dhe përdorimit të substancave apo metodave doping të ndaluara nga KON, Agjencia Botërore Antidoping si dhe Organizata Kombëtare Antidoping;
 - g) të inkurajojë dhe të marrë masa në lidhje me kujdesin mjekësor për sportistët dhe shëndetin tyre;
 - h) të zbatojë Kodin e Lëvizjes Olimpikë për Parandalimin e Manipulimit të Garave.
 - i) të mbështesë e të ndikojë në ruajtjen, pasurimin dhe mbrojtjen e mjedisit;
 - j) të përfaqësojë Lëvizjen Olimpikë Shqiptare për të gjitha çështjet me interes të përgjithshëm kombëtar pranë organeve shtetërore e publike në Shqipëri dhe jashtë saj;
 - k) të grupojë të gjitha Organizatat Sportive me karakter kombëtar që zhvillojnë veprimtari sportive të njohura në bazë të Legjislacionit Shqiptar dhe të koordinojë veprimete tyre;
 - l) të njohë dhe të certifikojë Organizatat Sportive si anëtare të KOKSH-it në përputhje me parashikimet të Neni 11 (Anëtarësimi).
 - m) të respektojë rregullat dhe rregulloret e KON-it;
 - n) të jetë përgjegjës përpara KON për respektimin në Shqipëri të Rregullave 7-14 dhe aktit të dalë në bazë të Rregullave 7-14 të KO-së. Të marrë masa për ndalimin e përdorimit



të ndonjëres prej pasurive Olimpike që do të vinte në kundërshtim me këto Rregulla ose Aktet e dala në bazë të tyre. Gjithashtu, do të bëjë përpjekje për të siguruar, në favor të KON-it, mbrojtjen e pasurive Olimpike të KON-it. Për më tepër, KOKSH mund të përdorë simbolin Olimpik, flamurin, moton dhe himnin Olimpik vetëm në kuadër të aktiviteteve të veta jofitimprurëse, me kusht që ky përdorim të kontribuojë në zhvillimin e Lëvizjes Olimpike dhe të mos cenojë dinjitetin e saj, dhe me kusht që KOKSH të ketë marrë miratimin paraprak të Bordit Ekzekutiv të KON-it;

- o) të bashkëpunojë në përgatitjen dhe përzgjedhjen e sportistëve shqiptarë dhe të sigurojë pjesëmarrjen e tyre në Lojërat Olimpike dhe të gjitha Lojërat Rajonale, Kontinentale dhe Ndërkontinentale, nën kujdesin e KON-it;
- p) të mbështesë promovimin e sportistëve në planin social, gjatë dhe pas karrierës së tyre sportive;
- q) të promovojë realizimin dhe përmirësimin e infrastrukturës dhe të pajisjeve të nevojshme për zhvillimin e aktiviteteve fizike e sportive;
- r) të krijojë dhe të japë çmime dhe urdhra të destinuara për të ndihmuar dhe inkurajuar grupime, praktikues dhe drejtues të sportit që japin dhe/ose kanë dhënë kontribut të shquar për Lëvizjen Olimpike;
- s) të inkurajojë dhe të ndihmojë anëtarët e tij në mirëfunksionimin e veprimtarisë së tyre;
- t) të inkurajojë sportin për personat me aftësi të kufizuar, e në veçanti të nxisë zhvillimin e sporteve të unifikuara;
- u) të marrë pjesë dhe të bashkëpunojë me të gjitha institucionet shtetërore dhe joshetërore që ndihmojnë në zhvillimin e sportit dhe të aktiviteteve fizike për të gjithë. Ndërkohë, KOKSH nuk duhet të marrë pjesë në asnjë aktivitet që do të ishte në kundërshtim me KO.

Neni 7 Detyrat dhe kompetencat e KOKSH-it

KOKSH ka për detyrë dhe kompetencë:

- a) ekskluzive përfaqësimin e Shqipërisë në Lojërat Olimpike dhe në garat shumësportëshe, kontinentale e botërore, udhëhequr nga KON;
- b) të marrë pjesë në Lojërat Olimpike duke dërguar sportistët e tij, dhe duke u angazhuar të respektojë rregullat e KO si dhe urdhëresat e nxjerra në zbatim të saj;
- c) të formojë, organizojë dhe të drejtojë delegacionin shqiptar në Lojërat Olimpike dhe garat shumësportëshe, rajonale, kontinentale apo botërore të organizuara nga KON. KOKSH është përgjegjës për sjelljen e anëtarëve të delegacionit të tij;
- d) ekskluzive të zgjedhë dhe të caktojë qytetin i cili mund të kandidojë për organizimin e Lojërave Olimpike në Shqipëri;
- e) të sigurojë lidhjen me KON, Komitetet Olimpike Kombëtare të huaja, Komitetet Organizatore të Lojërave Olimpike dhe të Lojërave Rajonale Kontinentale dhe Ndërkontinentale;

- f) të ruajë dhe të mbrojë autonominë e vet, si organizatë e pavarur nga çdo lloj ndikimi politik, fetar, ekonomik etj., që mund të pengojnë veprimtarinë e tij të jetë në përputhje të plotë me KO;
- g) t'u japë çmime sportistëve, trajnerëve dhe specialistëve për rezultatet e arritura në Lojërat Olimpike, Mesdhetare, Europiane dhe në ditët Festivalin Olimpik Rinor Europian (EYOF) brenda mundësive buxhetore.

KREU III EMBLEMA, FLAMURI DHE HIMNI

Neni 8 Emblema

Emblema institucionale e KOKSH-it konsiston në një dizajnim të përbashkët të emrit të KOKSH në pjesën e sipërme, me krahët e shqiponjës së flamurit kombëtar vendosur në pjesën e mesit dhe simbolit olimpik të pesë rrathëve me ngjyra të vendosur në pjesën e poshtme, ashtu siç është paraqitur në Nenin 9.

Neni 9 Flamuri

Flamuri i KOKSH-it ka një fushë në ngjyrë të bardhë, me emblemën institucionale të KOKSH-it në qendër.



Emblema dhe flamuri të përmendur më sipër janë miratuar nga Komiteti Ekzekutiv i KON-it. Vetëm KOKSH ka të drejtën dhe detyrimin për t'i përdorur në aktivitetet e tij, përfshirë këtu edhe Lojërat Olimpike. Çdo ndryshim i emblemës dhe i flamurit duhet të miratohet nga Komiteti Ekzekutiv i KON-it. E njëjta vlen për emblemën komerciale të KOKSH-it, e cila mund të adoptohet nga Komiteti Ekzekutiv (KE), me miratimin paraprak të Komitetit Olimpik Ndërkombëtar (IOC).

KREU IV PËRBËRJA DHE ANËTARËSIMI

Neni 10 Përbërja

KOKSH përbëhet nga:

- a) të gjitha Federatat Kombëtare të njohura në bazë të Legjislacionit Shqiptar të cilat drejtojnë veprimtarinë e një sporti që figuron në programin Olimpik dhe që janë të anëtarësuar në Federatat Ndërkombëtare përkatëse të njohura nga KON (minimumi pesë federata të tilla) (në vijim “**Federatat Olimpikë**”);

dy përfaqësues atletë të zgjedhur nga Komisioni i Sportistëve të KOKSH-it, ku të paktën një nga të cilët duhet të jetë sportist që ka marrë pjesë në të paktën një nga tre edicionet e fundit të Lojërave Olimpikë. Dy Përfaqësuesit duhet të jenë një mashkull

- dhe një femër, për të promovuar barazinë gjinore në sport. Mandati i tyre përfundon maksimumi në fund të Olimpiadës së tretë pas pjesëmarrjes së tyre të fundit në Lojërat Olimpike. Mandati i përfaqësuesit është katër vjeçar dhe nuk përfundon në rastin e përfundimit të ushtrimit të veprimtarisë sportive;
- b) Shtetas shqiptarë anëtarë të KON-it, nëse ka.
- c) Federatat Kombëtare të njohura në bazë të Legjislacionit Shqiptar të cilat drejtojnë veprimtarinë e një sporti që nuk figuron në programin Olimpik dhe që janë të anëtarësuar në Federatat Ndërkombëtare përkatëse të njohura nga KON (në vijim **“Federatat Jo-Olimpikë”**);
- d) Shoqëritë Sportive, Shoqatat Sportive, Klubet Sportive të tjera të cilat drejtojnë Veprimtari Sportive në një sport që figuron në programin Olimpik dhe që janë të anëtarësuar në Federatat Ndërkombëtare përkatëse të njohura nga KON (vetëm nga një për sport), por që për të cilin ende nuk ekziston një Federatë Kombëtare e njohur në bazë të Legjislacionit Shqiptar (në vijim **“Shoqata Olimpikë”** dhe së bashku me Federatat Olimpikë **“Organizatat Sportive Olimpikë”**);
- e) Shoqëritë Sportive, Shoqatat Sportive, Klubet Sportive të tjera të cilat drejtojnë Veprimtari Sportive në një sport që nuk figuron në programin Olimpik dhe që janë të anëtarësuar në Federatat Ndërkombëtare përkatëse të njohura nga KON (vetëm nga një për sport), por që për të cilin ende nuk ekziston një Federatë Kombëtare e njohur në bazë të Legjislacionit Shqiptar (në vijim **“Shoqata Jo-Olimpikë”** dhe së bashku me Federatat Jo-Olimpikë **“Organizatat Sportive Jo-Olimpikë”**).
- f) Komitetet Olimpikë Rajonale, të cilat ngrihen dhe funksionojnë në nivel Prefekturë. KOR mund të krijohet kur së paku në këtë rajon të zhvillohen pesë sporte të përfshira në programin Olimpik. KOR është organi më i lartë i Lëvizjes Olimpikë në Prefekturën që ai përfaqëson. Çdo KOR regjistrohet në gjykatë dhe fiton anëtarësimin në KOKSH me statusin e një organizate jo-fitimprurëse. Në Republikën e Shqipërisë do të ngrihen dhe funksionojnë deri në 6 KOR, megjithatë ky numër do të referohet Nenit 11, pikes 2 të këtij Statuti.
- g) grupime apo organizata të tjera sportive apo përfaqësuesit e tyre, pa të drejtë vote;
- h) anëtarët e Komitetit Ekzekutiv të KOKSH-it, pa të drejtë vote; anëtarët e KPKSH.
- i) anëtarët e nderit të KOKSH-it, pa të drejtë vote.

Neni 11 Anëtarësimi

1. KOKSH nuk mund të njohë më shumë se një Federatë Kombëtare për të njëjtin sport.
2. Organizatat Olimpikë ose përfaqësuesit e zgjedhur nga to duhet të përbëjnë shumicën e votave të Asamblesë së Përgjithshme si dhe të Komitetit Ekzekutiv.
3. Anëtarësimi i përkohshëm i një Organizate Sportive bëhet me vendim të Komitetit Ekzekutiv. Ky vendim duhet të shqyrtohet nga Asambleja e Përgjithshme e radhës, në bazë të vendimit të së cilës anëtarit të përkohshëm mund t'i jepet statusi i anëtarit me të drejta të plota. Në rast se Asambleja e Përgjithshme e refuzon miratimin (duke dhënë dhe arsyet ligjore apo statutores për këtë refuzim), anëtari i përkohshëm nuk do ta gëzojë më statusin e anëtarit të përkohshëm. Ky subjekt mund të riaplikojë për të marrë statusin e anëtarit, pasi

të jetë korrigjuar shkaku që ka bërë Asamblenë e Përgjithshme ta refuzojë atë. Gjatë kohës së anëtarësimit të përkohshëm, anëtarët e përkohshëm gëzojnë të njëjtat të drejta si anëtarët e tjerë në lidhje me pjesëmarrjen në aktivitetet e organizuara nga KOKSH, por nuk kanë të drejtë vote.

4. Titulli i anëtarit të nderit, mund t'iu jepet nga Asambleja e Përgjithshme me propozim të Komitetit Ekzekutiv individëve ose personave juridik që kanë kontribute të spikatura në shërbim të lëvizjes Olimpike Shqiptare dhe sportit shqiptar.
5. Autoritetet shtetërore apo publike nuk mund të caktojnë asnjë anëtar të KOKSH-it. Pavarësisht nga sa më lart, KOKSH mundet të vendosë, në diskrecionin e tij të plotë, që të zgjedhë si anëtarë përfaqësues të këtyre autoriteteve.
6. Tarifa e kuotizacionit të anëtarëve të KOKSH-it, caktohet nga Asambleja e Përgjithshme me propozim të Komitetit Ekzekutiv.
7. Anëtarët e KOKSH-it, përveç administratorëve profesionistë të sporteve, nuk lejohet të pranojnë asnjë pagesë ose shpërblim të çfarëdolloji për shërbimet e tyre ose për kryerjen e detyrave të tyre. Ata duhet të rimbursohen për shpenzimet që kryejnë për udhëtimet, akomodimin dhe shpenzime të tjera të arsyeshme të kryera për ushtrimin e funksioneve të tyre.
8. KOKSH do të mbajë dhe azhurnojë rregullisht një regjistër të anëtarëve dhe të kategorive të cilave ata iu përkasin, i aksesueshëm nga të gjithë në faqen e internetit të KOKSH-it.
9. Nëse Shoqatat Olimpike dhe/ose Shoqatat Jo-Olimpike marrin titullin Federatë Kombëtare në bazë të Legjislacionit Shqiptar, ato do të rikategorizohen si Federata Kombëtare në regjistrin e anëtarëve të KOKSH-it. Nëse gjatë mandatit të tyre si anëtar i KOKSH-it do të krijohet një Federatë Kombëtare që mbulon sportin përkatës, mandati i tyre do të përfundojë me pranimin në KOKSH të Federatës Kombëtare përkatëse.

Neni 12 Kriteret Bazë për Anëtarësimin apo Përfaqësimin në KOKSH

1. Anëtarët e KOKSH-it që janë individë apo përfaqësuesit e Organizatave Sportive anëtare në KOKSH duhet:
 - a) të jenë shtetas të Republikës së Shqipërisë;
 - b) të jenë me vendbanim dhe vendqëndrim të përhershëm Shqipëri;
 - c) të kenë Figurë të Pastër Morale;
 - d) të mos të jenë të përjashtuar nga KON;
 - e) të kenë arsim të lartë universitar;
 - f) të kenë dhënë kontribut në zhvillimin e sportit;
 - g) të mos jenë në kushtet e konfliktit të interesave me funksionin e anëtarit apo të përfaqësuesit të anëtarit në KOKSH, dhe
 - h) të jenë më pak se sa shtatëdhjetë vjeç gjatë mandatit.
2. Personat juridik që janë anëtarë të KOKSH-it duhet:

- a) të jenë të regjistruar në gjykatë dhe/ose në Qendrën Kombëtare të Biznesit të Republikës së Shqipërisë, sipas kërkesave të Legjislacionit Shqiptar;
 - b) të jenë themeluar, të vazhdojnë të ekzistojnë, të konsiderohen në mbarëvajtje, si dhe të kenë përmbushur të gjitha detyrimet e tyre ligjore në përputhje me Legjislacionin Shqiptar.
3. Kandidatët për anëtarë të KOKSH-it duhet të verifikohen nga KVE për plotësimin e kriterëve si më lart, përpara se KE apo AP të marrë një vendim për pranimin e tyre si anëtarë të KOKSH-it.

Neni 13 Humbja e anëtarësisë

Anëtarët e KOKSH-it humbasin të drejtën e anëtarësisë në rast:

- a) të heqjes së anëtarësisë nga Asambleja e Përgjithshme e KOKSH-it;
- b) të përjashtimit nga KON;
- c) humbjes së jetës;
- d) humbjes së zotësisë juridike.
- e) të dorëheqjes nga anëtarësia në KOKSH;
- f) të shkrirjes, mbylljes, fillimit të procedurave të falimentimit apo likuidimit të Organizatës Sportive;
- g) të mos organizimit të aktiviteteve dhe garave sportive vjetore në disiplinat përkatëse në përputhje me statutet e tyre, përveç kur ky mosrespektim vjen për shkak të Forcës Madhore;
- h) të përjashtimit nga KOKSH për motivet e mëposhtme:
 - (1) Veprimtari në kundërshtim me, apo shkelje të, KO, Legjislacionit Shqiptar, Statutit dhe Rregullores së Brendshme të KOKSH.
 - (2) Refuzim të zbatimit të vendimeve të marra nga Asambleja e Përgjithshme dhe/ose Komiteti Ekzekutiv i KOKSH.
 - (3) Mospagim i kuotizacionit vjetor të anëtarësisë.
 - (4) Mospërmbushja e detyrimeve të parashkuara në këtë Statut.
- i) Në rastin e anëtarësisë së përkohshme, refuzimit nga Asambleja e Përgjithshme e KOKSH për pranimin si anëtar me status të plotë.
- j) Anëtarët e Asamblesë që kanë humbur anëtarësinë për shkaqet e parashikuara në paragrafët a), b), e), g), h) nuk lejohen të kandidojnë për tu anëtarësuar për një periudhë prej 2 vjetësh nga momenti i humbjet së anëtarësisë, përveçse nëse vendoset ndryshe nga Asambleja e Përgjithshme.

Neni 14 Masat dhe Sanksionet



1. Kur një anëtar i Asamblesë nuk përmbush detyrat e tij, vepron në kundërshtim me, apo shkelje të, Legjislacionit Shqiptar, shkel KO, shkel Statutin apo Rregulloren e Brendshme të KOKSH-it, ose nuk respekton apo nuk zbaton vendimet e organeve të KOKSH-it, ai iu nënshtrohet masave dhe sanksioneve të mëposhtme (në varësi të rëndësisë së fakteve dhe shkallës së dëmit apo shkeljes):
 - a) paralajmërim;
 - b) vërejtje;
 - c) pezullim;
 - d) përjashtim.
2. Vendimi për të dhënë një paralajmërim, vërejtje ose pezullim merret nga Komiteti Ekzekutiv pasi t'i jetë dhënë mundësia anëtarit përkatës për t'u dëgjuar. Komiteti Ekzekutiv do të raportojë gjithçka në mbledhjen e ardhshme të Asamblesë së Përgjithshme.
3. Vendimi për përjashtim merret nga Asambleja e Përgjithshme me propozim të Komitetit Ekzekutiv dhe pasi t'i jetë dhënë mundësia anëtarit përkatës për t'u dëgjuar. Ky vendim merret me praninë e një kuorumi prej 2/3 të anëtarëve me të drejtë vote dhe me një shumicë prej 2/3 të anëtarëve të pranishëm që votojnë. Vendimi për përjashtim ose jo duhet të jetë i pari në rendin e ditës të AP-së përkatëse.

KREU V ORGANET E KOKSH-it

Neni 15 Organet e KOKSH-it

Organet e KOKSH-it janë:

- a) Asambleja e Përgjithshme, si organi më i lartë vendimmarrës.
- b) Komiteti Ekzekutiv, si organ ekzekutiv.
- c) Komisioni i Verifikimeve dhe i Etikës.
- d) Komisioni i Sportistëve.
- e) Komisione të tjera të aprovuara nga Komiteti Ekzekutiv në bazë të Rregullores së Brendshme të KOKSH-it.

Neni 16 Asambleja e Përgjithshme

1. Asambleja e Përgjithshme mbledhet së paku një herë në vit për të miratuar raportin e aktivitetit, atë financiar si dhe buxhetin e propozuar, dhe është organi që vendos për çështje, të tilla si përcaktimi i fushave dhe i programeve të veprimtarisë, mbikëqyr dhe kontrollon rregullisht realizimin e tyre, shqyrton çështjet ekonomike, financiare dhe miraton aktet më të rëndësishme në lidhje me buxhetin e KOKSH-it dhe shpenzimet për vitin e ardhshëm, zgjedh anëtarët e organeve ekzekutive dhe vendos për çështje të tjera të parashikuara shprehimisht në këtë statut apo në Legjislacionin Shqiptar.



2. Asambleja e Përgjithshme, përveç sa parashikohet në paragrafin 1 këtu më sipër, diskuton dhe aprovon ndryshimet që janë bërë në përbërjen e KOKSH-it nga mbledhja e mëparshme.
3. KE i propozon Asamblesë së Përgjithshme tri kandidatura për auditorin e pasqyrave financiare të KOKSH-it, ndër të cilët zgjidhet kandidati i cili merr më tepër vota nga Asambleja. Mandati i audituesit zgjat për një periudhë 5-vjeçare, përveç rasteve kur AP vendos ta ndërpresë atë më herët.
4. Asambleja e Përgjithshme përbëhet nga anëtarët e përmendurte Neni 10(Përbërja)më sipër.
5. Organizatat Olimpike që janë anëtarë të KOKSH-it dhe që kanë të drejtën e dy votave, mund të përfaqësohen në Asamblesë të Përgjithshme të KOKSH-it me dy përfaqësues të cilët mund të jenë presidenti, dhe/ose sekretari i përgjithshëm, dhe/ose një anëtar i organit drejtues të saj (i cili duhet të jetë i mandatuar specifikisht për këtë qëllim nga organet drejtuese përkatëse). Për efekt sqarues, pavarësisht nëse Organizatat Olimpike përfaqësohen nga një apo dy përfaqësues, ato kanë vetëm dy vota që mund të ushtrohen veç e veç ose së bashku.
6. Përfaqësuesit e një Organizate Sportive që kanë të drejtën e një vote, mund të jenë presidenti, dhe/ose sekretari i përgjithshëm, dhe/ose një anëtar i organit drejtues të saj (i cili duhet të jetë i mandatuar specifikisht për këtë qëllim nga organet drejtuese përkatëse të Organizatës Sportive).
7. 7. Data e Asamblesë së Përgjithshme vjetore vendoset nga Komiteti Ekzekutiv, por ajo në të gjitha rastet do të mblidhet jo më vonë se sa data 30 Qershor e vitit përkatës. Ajo thirret nga Presidenti i KOKSH-it, dhe/ose nga 2/3 e anëtarëve të KE-së. Data, ora, vendi, dhe rendi i ditës së Asamblesë së Përgjithshme u bëhet e ditur anëtarëve, të paktën, 30 ditë përpara datës së caktuar
8. Anëtarët e KOKSH-it mund të paraqesin propozimet e tyre për rendin e ditës pranë Komitetit Ekzekutiv të KOKSH-it, të paktën 20 ditë përpara datës së Asamblesë, përfshirë dhe datën e postës. Pas shqyrtimit të tyre, KE vendos për çështjet e rendit të ditës dhe njofton secilin prej anëtarëve të Asamblesë për rendin e ditës përfundimtar jo më vonë se 10 ditë para datës së Asamblesë.
9. AP drejtohet nga Presidenti i KOKSH-it dhe në mungesë të tij nga zv.Presidenti. Kur edhe zv.Presidenti mungon, AP drejtohet nga anëtari më i vjetër në moshë i Komitetit Ekzekutiv i pranishëm në AP.
10. Jo më vonë se sa 20 ditë para datës së Asamblesë së Përgjithshme, Sekretari i Përgjithshëm i KOKSH-it duhet t'i dorëzojë KVE-së listën e anëtarëve si dhe dokumentacionin që provon se ata kanë paguar kuotizacionin përkatës pranë KOKSH.
11. Jo më vonë se 20 ditë para datës së Asamblesë së Përgjithshme, të gjithë anëtarët e KOKSH duhet të dorëzojnë pranë KVE-së:
 - a) në rastin e Organizatave Sportive:
 - (1) një vërtetim nga gjykata, të datuar brenda 3 muajve nga data e Asamblesë së Përgjithshme, i cili specifikon organet drejtuese të saj;
 - (2) një ekstrakt nga Qendra Kombëtare e Biznesit, nëse është e aplikueshme; dhe
 - (3) informacion dhe dokumentacion në lidhje me Veprimtarinë Sportive që kanë zhvilluar gjatë vitit në përputhje me statutet e tyre.



- b) në rastin e një përfaqësuesi të Organizatës Sportive të ndryshëm nga Presidenti dhe/ose Sekretari (në rastin e Organizatave Sportive me dy vota) apo të ndryshëm nga Presidenti (në rastin e Organizatave Sportive me një votë) si dhe në rastin e të gjithë anëtarëve të tjerë që janë persona juridik, mandatin e përfaqësimit nga organi drejtues përkatës.

Anëtarët që nuk dorëzojnë dokumentet e mësipërme nuk mund të votojnë në Asamblenë e Përgjithshme të radhës.

12. Jo më vonë se 10 (dhjetë) ditë para Asamblesë së Përgjithshme, KVE u dërgon anëtarëve të KOKSH-itme postë elektronike listën e anëtarëve që kanë përmbushur kriteret për t'u përfaqësuar(me apo pa të drejtë vote, sipas rastit) në Asamblenë e radhës.Anëtarët e KOKSH-it kanë 5 (pesë) ditë kohë që të ankohen me shkrim, apo të bëjnë vërejtje të dokumentuara pranë KVE në lidhje me listën e anëtarëve të dërguar nga KVE, vërejtje të cilat duhet të shqyrtohen dhe për të cilat merret një vendim brenda 3 (tri) ditëve nga KVE. Vendimi iu komunikohet menjëherë elektronikisht anëtarëve me të drejtë vote si dhe Komitetit Ekzekutiv.
13. Në mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme, përfaqësuesit e anëtarëve të KOKSH-it duhet të kenë me vete dokumentin e identifikimit (pasaportë, kartë identiteti).
14. Përpara fillimit të punimeve të çdo Asambleje të Përgjithshme, KVE bën verifikimin përfundimtar të mandatave dhe të identitetit të anëtarëve dhe të përfaqësuesve të tyre që janë të pranishëm në AP, dhe bën publik raportin e tij përfundimtar në lidhje me anëtarët që kanë të drejtë vote në AP.
15. Asambleja e Përgjithshme konsiderohet e vlefshme në qoftëse janë të pranishëm më shumë se gjysma e anëtarëve me të drejtë vote, nga ku shumica e tyre të jenë nga Federatat Olimpikë dhe Organizatat Sportive të cilat ushtrojnë sporte që figurojnë në programin Olimpik. AP merr vendime me shumicën e anëtarëve të pranishëm me të drejtë vote, përveç rasteve kur parashikohet ndryshe në këtë Statut.
16. Nëse numri i anëtarëve pjesëmarrës nuk plotësohet, një Asamble e Përgjithshme tjetër duhet të mbledhet brenda 15 ditësh dhe do të jetë e vlefshme vetëm nëse janë të pranishëm jo më pak se 1/3 e anëtarëve të KOKSH-it që kanë të drejtë vote, nga ku shumica e tyre të jenë nga Federatat Olimpikë dhe Organizatat Sportive që ushtrojnë sporte që figurojnë në programin Olimpik. Nëse sërish kuorumi i nevojshëm nuk plotësohet, e njëjta procedurë do të përsëritet dhe këtë herë ajo do të jetë e vlefshme pavarësisht nga numri i anëtarëve pjesëmarrës.
17. Pavarësisht nga sa parashtrohet më lart në parashikimet e këtij Neni 16(Asambleja e Përgjithshme), një Asamble e Përgjithshme që ka në rendin e ditës së saj:
- (1) zgjedhje;
 - (2) përjashtime të anëtarëve;
 - (3) mocione mosbesimi për organet e KOKSH-it;
 - (4) miratimin apo ndryshime në Statutin e KOKSH-it;
 - (5) miratimin apo ndryshime të Rregullores së KAS-it;

nuk do të konsiderohet e vlefshme nëse nuk janë të pranishëm të paktën 2/3 e anëtarëve me të drejtë vote, nga ku shumica e tyre të jenë nga Organizatat Olimpikë.Pavarësisht nga fjalia paraardhëse, nëse kuorumi i anëtarëve pjesëmarrës nuk plotësohet, një Asamble e

Përgjithshme tjetër me të njëjtin rend dite duhet të mbledhet brenda 15 ditësh dhe do të jetë e vlefshme vetëm nëse janë të pranishëm jo më pak se 1/2 e anëtarëve të KOKSH-it që kanë të drejtë vote, nga ku shumica e tyre të jenë nga Organizatat Olimpике. Nëse sërish kuorumi i nevojshëm nuk plotësohet, e njëjta procedurë do të përsëritet dhe këtë herë ajo do të jetë e vlefshme vetëm nëse janë të pranishëm jo më pak se 1/3 e anëtarëve të KOKSH-it, nga ku shumica e tyre të jenë nga Organizatat Olimpике.

18. AP shqyrton të gjitha çështjet e vëna në rendin e ditës dhe merr vendimet përkatëse.
19. Në për raste pandemie apo force madhore, apo kur kërkohet vendimarrje e shpejte, me propozim të Presidentit, Komiteti Ekzekutiv mund ti kërkojë anëtarëve të KOKSH të aplikojnë marrjen e Vendimeve Qarkulluese, duke ushtruar të drejtën e votës të shprehur me shkrim brenda një afati të arsyeshëm dhe të qartë. Përveç rasteve kur përcaktohet ndryshe në këtë Statut, vendimet Qarkulluese marrin fuqi nëse më shumë se 50% e anëtarësisë me të drejtë vote votojnë pro vendimit të propozuar në përfundim të afatit të përcaktuar.

Neni 17 Asambleja e Përgjithshme Zgjedhore

1. Asambleja e Përgjithshme Zgjedhore zhvillohet një herë në 4 vjet, zakonisht brenda 3 muajve pas përfundimit të Lojërave Olimpике Verore (por pavarësisht nëse ato zhvillohen ose jo), por jo më vonë se 31 dhjetori i vitit përkatës. Asambleja Zgjedhore mund të zhvillohet dhe më herët për një pozicion të caktuar në kushtet kur të zgjedhurit e KOKSH-it kanë humbur statusin e tyre në bazë të këtij Statuti dhe vendi vakant nuk mund të plotësohet në përputhje me dispozitat e Statutit.
2. Procedura e zgjedhjes së Presidentit, zv/Presidentit dhe anëtarëve të Komitetit Ekzekutiv (përveç sportistit përfaqësues të Komisionit të Sportistëve) dhe anëtarët e KVE-së do të kryhet si më poshtë:
 - a) Formularët e propozimit, do të dërgohen së bashku me njoftimin e mbledhjes dhe rendin e ditës për të gjithë anëtarët e Asamblesë jo më vonë se tridhjetë (30) ditë para Asamblesë së Përgjithshme Zgjedhore.
 - b) Propozimet për kandidaturat duhet të dorëzohen pranë KVE nga çdo anëtar me të drejtë vote jo më vonë se njëzet (20) ditë para Asamblesë së Përgjithshme Zgjedhore. Çdo anëtar me të drejtë vote ka të drejtë të propozojë vetëm një (1) kandidat për vetëm njërin nga tre pozicionet e Presidentit, zv/Presidentit ose anëtarit të Komitetit Ekzekutiv. Anëtar i propozues nuk ka të drejtën të propozojë kandidatë të cilët janë anëtarë të një Federate ose shoqate tjetër.
 - c) KVE do të njoftojë të gjithë anëtarët me të drejtë vote për kandidaturat që kanë plotësuar kriteret përkatëse duke dhënë emrat dhe kualifikimin (CV e shkurtër) e kandidatëve për president, zv.president dhe anëtarë të Komitetit Ekzekutiv jo më vonë se dhjetë (10) ditë para Asamblesë së Përgjithshme Zgjedhore. Anëtarët kanë 5 (pesë) ditë kohë që të ankohen me shkrim apo që të bëjnë vërejtje të dokumentuara pranë KVE në lidhje me listën e kandidaturave, vërejtje të cilat duhet të shqyrtohen dhe për të cilat merret një vendim brenda 3 (tri) ditëve nga KVE. Vendimi iu komunikohet menjëherë elektronikisht anëtarëve me të drejtë vote si dhe Komitetit Ekzekutiv.

- d) Para fillimit të punimeve të Asamblesë së Përgjithshme Zgjedhore KVE bën verifikimet sipas paragrafit 1 të Neni 16 (Asambleja e Përgjithshme) më lart. KVE do të përgatisë një kuti votimi transparente dhe të gjitha fletët e votimit që do t'u jepen delegatëve votues të Asamblesë së Përgjithshme. KVE u shpjegon anëtarëve procedurën e zgjedhjeve dhe sqaron çdo pyetje të tyre përpara se të vazhdojnë me zgjedhjet.
- e) Zgjedhjet për pozicionet e Presidentit, Zv. Presidentit, anëtarëve të KE-së dhe anëtarëve të KVE-së do të zhvillohen veçmas me votë të fshehtë dhe sipas këtij rendi:
- (1) Kandidati që merr më shumë se 50% të votave të vlefshme të të gjithë anëtarëve të pranishëm do të deklarohet si i zgjedhuri nga AP.
 - (2) Nëse ka më shumë se dy kandidatë për një pozicion dhe asnjëri prej tyre nuk merr më shumë se 50% të votave të vlefshme të të gjithë anëtarëve të pranishëm që në votimin e parë, atëherë do të ketë një votim të dytë mes dy kandidatëve që kanë marrë numrin më të lartë të votave në votimin e parë. Nëse, dhe në votimin e dytë, asnjë nga kandidatët nuk merr më shumë se sa 50% të votave të vlefshme të të gjithë anëtarëve të pranishëm, votimi do të përsëritet derisa një kandidat të marrë më shumë se 50% të votave të vlefshme të të gjithë anëtarëve të pranishëm, i cili do të shpallet si i zgjedhuri nga AP. Në rast barazimi në çdo fazë të procesit, votimi do të përsëritet ndërmjet kandidatëve në fjalë derisa të zgjidhet barazimi.
 - (3) Zgjedhjet për 8 (tetë) anëtarët e Komitetit Ekzekutiv (përveç Presidentit, Zv. Presidentit, dhe përfaqësuesit të Komisionit të Sportistëve) duhet të bëhen në bazë të një liste alfabetike kandidatësh dhe me votim të fshehtë. Anëtarët e KE-së do të zgjidhen me më shumë se 50% të votave të vlefshme të të gjithë anëtarëve të pranishëm. Nëse nga faza e parë e votimit del se janë më shumë se 8 (tetë) kandidatë që marrin më shumë se 50% të votave të vlefshme të të gjithë anëtarëve të pranishëm, do të shpallen të zgjedhur 8 (tetë) kandidatët që kanë marrë më shumë vota. Nëse në votimin e parë rezulton që numri i kandidatëve që kanë marrë më shumë se 50% të votave të vlefshme është më i vogël se 8 (tetë), do të mbahet një votim tjetër ku kandidatët e nevojshëm për të plotësuar numrin e 8 (tetë) anëtarëve të KE do të zgjidhen me shumicën e votave të vlefshme të të gjithë anëtarëve të pranishëm. Në rast barazimi në çdo fazë të procesit, votimi do të përsëritet ndërmjet kandidatëve në fjalë derisa të zgjidhet barazimi.
 - (4) Zgjedhjet për 3 (tre) anëtarët e Komisionit të Verifikimit dhe të Etikës duhet të bëhen në bazë të një liste kandidatësh dhe me votim të fshehtë. Anëtarët e KVE do të zgjidhen vetëm me më shumë se 50% të votave të vlefshme të të gjithë anëtarëve të pranishëm. Nëse nga votimi del se nga lista e kandidatëve janë zgjedhur me më shumë se 50% të votave të vlefshme të të gjithë anëtarëve të pranishëm më shumë se sa 3 (tre) kandidatë, do të shpallen të zgjedhur 3 (tre) kandidatët që kanë marrë më shumë vota. Nëse nga votimi del se nga lista e kandidatëve kanë arritur pragun e më shumë se 50% më pak se sa 3 (tre) kandidatë, do të shpallen të zgjedhur vetëm ata kandidatë që kanë kaluar pragun. Votimi do të përsëritet për kandidatët e mbetur derisa të plotësohet numri i 3 (tre) anëtarëve me kandidatë që kapërcejnë pragun e më shumë se 50% të votave të vlefshme të të gjithë anëtarëve të pranishëm.



- (5) Në përputhje me KO, përfaqësuesit e zgjedhur të Organizatave Olimpike duhet të përbëjnë shumicën e anëtarëve të Komitetit Ekzekutiv. Nëse në bazë të rezultateve të zgjedhjeve të zhvilluara në bazë të paragrafit (f) më lart, rezulton që nuk është arritur ky rezultat, atëherë KVE do të heqë nga lista e të zgjedhurve kandidatin e KE-së që nuk është përfaqësues i Organizatave Olimpike dhe që ka më pak vota, dhe do ta zëvendësojë atë me kandidatin e radhës që vjen nga Federatat Olimpike që ka më shumë vota. Kjo procedurë do të ribëhet, derisa shumica e anëtarëve të KE-së të përbëhet nga Organizatat Olimpike.
- (6) Në përputhje me orientimet e dhëna nga KON, për aq sa është e mundur, KE duhet që të përbëhet minimumi nga 30% apo 3 (tri) nga 11 (njëmbëdhjetë) anëtarë të gjinisë femër. Nëse në bazë të rezultateve të zgjedhjeve të zhvilluara në bazë të paragrafit e) më lart, rezulton që nuk është arritur ky rezultat, atëherë KVE do të heqë nga lista e të zgjedhurve kandidatin që ka më pak vota, dhe do ta zëvendësojë atë me kandidatin e radhës femër që ka më shumë vota nga lista e kandidatëve që kanë mbetur, gjithnjë duke ruajtur kriterin që shumica e anëtarëve të KE-së të përbëhet nga përfaqësues të Organizatave Olimpike siç është përcaktuar te Neni 11, paragrafi 2.
- (7) Pasi të gjithë anëtarët e pranishëm në votim të jenë fluar të votojnë, KVE do të hapë kutinë e votimit dhe do të numërojë votat publikisht. Kandidatët për pozicionet e zgjedhura kanë të drejtë të vëzhgojnë procesin nga afër pa ndërhyrë në punën e KVE-së.
- (8) Kopje të vendimeve të Asamblesë së Përgjithshme zgjedhore si dhe për zgjedhjet apo zëvendësimet e anëtarëve, i dërgohen KON-it. Të gjitha dokumentet do të vërtetohen si kopje të origjinalit të firmosur nga Presidenti dhe Sekretari i Përgjithshëm i KOKSH-it.

Neni 18 Asambleja e Përgjithshme e Jashtëzakonshme

1. Asambleja e Përgjithshme e Jashtëzakonshme mund të thirret nga (i) Presidenti i KOKSH-it, (ii) Komiteti Ekzekutiv në bazë të një vendimi të jo më pak se 2/3 e anëtarëve të tij, ose (iii) me kërkesë të jo më pak se 1/3 të anëtarëve të KOKSH-it me të drejtë vote. Në përputhje me paragrafin 2 të këtij Neni 18 (*Asambleja e Përgjithshme e Jashtëzakonshme*) më poshtë, rendi i ditës së Asamblesë së Jashtëzakonshme duhet të përmbajë arsyet për të cilat kërkohet që ajo të mblidhet nga kërkuesit e saj. Data, ora, vendi dhe rendi i ditës së Asamblesë së Jashtëzakonshme u bëhet e ditur anëtarëve të paktën 30 ditë përpara datës së caktuar.
2. Pavarësisht nga paragrafi 1 i këtij Neni 18 (*Asambleja e Përgjithshme e Jashtëzakonshme*) më lart, vetëm 1/3 e të gjithë anëtarëve me të drejtë vote në KOKSH (dhe jo Presidenti apo 2/3 e KE) kanë të drejtë të kërkojnë që në rendin e ditës të Asamblesë së Jashtëzakonshme të përfshihet një mocion mosbesimi ndaj Presidentit, Zv. Presidentit, dhe/ose anëtarëve të tjerë të KE-së, dhe/ose anëtarëve të KVE-së. Mocioni i mosbesimit duhet të aprovohet me të njëjtën kuorum dhe shumicë votash me të cilën është aprovuar zgjedhja e funksionit përkatës.

Presidenti, Zv. Presidenti dhe/ose anëtarë të tjerë të KE-së për të cilët është paraqitur një mocion mosbesimi do të konsiderohen të pezulluar dhe nuk mund të marrin pjesë apo të votojnë në mbledhjet e KE-së, derisa Asambleja e radhës të ketë marrë një vendim në lidhje

me mocionin e mosbesimit ndaj tij. Në mënyrë të ngjashme, çdo anëtar i KVE-së, ndaj të cilit është paraqitur mocioni i mosbesimit do të konsiderohet i pezulluar dhe nuk mund të ushtrojë aktivitein e tij/saj derisa Asambleja e radhës të ketë marrë një vendim në lidhje me mocionin e mosbesimit ndaj tij/saj.

3. Asambleja e Përgjithshme e Jashtëzakonshme duhet të zhvillohet brenda 45 ditëve nga data e dorëzimit të kërkesës në KE apo e marrjes së vendimit nga KE. Shpallja e datës, orës, vendit dhe e rendit të ditës duhet të bëhet brenda 10 ditëve nga marrja e kërkesës apo e vendimit. Nëse, pavarësisht prej kërkesës së 1/3 së anëtarëve, Presidenti apo KE nuk e thërret Asamblenë e Përgjithshme e Jashtëzakonshme, anëtarët që e kërkuan atë mund ta mbledhin vetë Asamblenë e Përgjithshme e Jashtëzakonshme dhe të informojnë të gjithë anëtarët e KOKSH-it dhe Komitetin Ekzekutiv për datën, orën, vendin dhe rendin e ditës së saj.
4. Procedurat e verifikimit nga KVE të përcaktuara te Neni 16 (*Asambleja e Përgjithshme*) do të aplikohen dhe për Asamblenë e Jashtëzakonshme.
5. Procedura e thirrjes së Asamblesë së Përgjithshme të Jashtëzakonshme mund të ndërpritet nëse pala nismëtare që ka bërë kërkesën për AP merr një vendim që AP nuk ka nevojë të mbledhet, vendim që u duhet dërguar anëtarëve jo më vonë se sa 3 (tri) ditë para ditës së parashikuar për mbledhjen e saj.

Neni 19 Votat në Asamblenë e Përgjithshme

1. Numri i votave që anëtarët gëzojnë në Asamblenë e Përgjithshmedo të jetë si më poshtë:
 - a) Federatat Olimpikë, të përcaktuara në paragrafin a) te Neni 10(*Përbërja*) këtu më sipër, do të kenë 1 (një) votë dhe 1 (një) votë suplementare (gjithsej dy vota) për të siguruar që, pavarësisht nga përbërja e KOKSH-it, kjo kategori e federatave kombëtare do të ketë shumicën e votimit në Asamblenë e Përgjithshme, siç kërkohet nga KO.
 - b) Përfaqësuesit e sportistëve të përcaktuar në paragrafin te Neni 10 (*Përbërja*) këtu më sipër, 1 (një) votë.
 - c) Anëtarët e KON-it të përcaktuar në paragrafin te Neni 10 (*Përbërja*) këtu më sipër, do të kenë 1 (një) votë.
 - d) Federatat Jo-Olimpikë, të përcaktuara në paragrafin b) te Neni 10 (*Përbërja*) këtu më sipër, 1 (një) votë.
 - e) Shoqatat Olimpikë të përcaktuara në paragrafin d) te Neni 10 (*Përbërja*) këtu më sipër, 1 (një) votë.
 - f) Shoqatat Jo-Olimpikë të përcaktuara në paragrafin d) te Neni 10 (*Përbërja*) këtu më sipër, 1 (një) votë.
 - g) KOR të përcaktuara në paragrafin g) të neni 10 (*Përbërja*) këtu më sipër, 1 votë;
 - h) KPKSH të përcaktuara në paragrafin h) te Neni 10 (*Përbërja*), këtu më sipër 1 votë;
 - i) Anëtarët e nderit do të gëzojnë të drejtën e votës këshillimore. Vota këshillimore ka vlerë simbolike dhe nuk do të llogaritet në votim.

2. Vota me delegim/prokurë nuk lejohet, përveç se në rastet kur i/e deleguari/a është anëtar i organizatës, përfaqësues i së cilës kërkon të delegojë nëpërmjet prokurës apo akteve të tjera ligjore votën e tij/saj.
3. Për çështje e shtruara në Asamblenë e Përgjithshme që kanë të bëjnë me Lojërat Olimpike mbahen në konsideratë vetëm votat e Organizatave Olimpike.
4. Pavarësisht nga sa më lart, të drejtën e votës në Asamblenë e Përgjithshme e gëzojnë vetëm ata anëtarë të KOKSH-it të cilët janë certifikuar nga KVE në bazë të paragrafit 11 të Neni 16 (*Asambleja e Përgjithshme*).

Neni 20 Dërgimi i Vendimeve të AP-së tek Anëtarët

Anëtarëve të KOKSH-it duhet t'iu dërgohen me postë elektronike të gjitha vendimet e Asamblesë së Përgjithshme, të Asamblesë së Jashtëzakonshme dhe të Asamblesë Zgjedhore brenda tri (3) ditëve nga data e tyre, nga stafi i KOKSH-it.

Neni 21 Komiteti Ekzekutiv

1. Komiteti Ekzekutiv është organi ekzekutiv i KOKSH-it. Anëtarët e tij zgjidhen nga Asambleja e Përgjithshme e KOKSH-it dhe ai përbëhet nga 11 vetë (përveç rastit kur ka dhe anëtarë *ex-officio* sipas paragrafit 7 të Neni 21 (*Komiteti Ekzekutiv*):
 - a) Presidenti
 - b) Zv.Presidenti
 - c) Një (1) sportist i cili njëkohësisht është anëtar i Komisionit të Sportistëve dhe është i përzgjedhur nga Komisioni i Sportistëve dhe i miratuar nga Asambleja e Përgjithshme.
 - d) Tete (8) anëtarë të tjerë.
2. Komiteti Ekzekutiv drejton veprimtarinë e KOKSH-it midis Asambleve të Përgjithshme dhe kujdeset për ekzekutimin e vendimeve dhe të objektivave të vendosur nga Asambleja e Përgjithshme. Anëtarët e KE-së zgjidhen për një periudhë 4-vjeçare, dhe jo më shumë se 3 herë (gjithsej 12 vjet).
3. Detyrat e anëtarëve të KE-së përcaktohen në Rregulloren e Brendshme të funksionimit të KOKSH-it, e cila përgatitet nga KE në zbatim të këtij Statuti.
4. Komiteti Ekzekutiv ka çdo kompetencë tjetër që nuk i jepet në mënyrë të shprehur një organi tjetër sipas këtij Statuti, Rregullorja e Brendshme dhe/ose Legjislacionit Shqiptar.
5. Secili nga anëtarët e KE-së duhet të plotësojë të paktën kriteret e mëposhtme në mënyrë kumulative:
 - a) të jetë shtetas i Republikës së Shqipërisë;
 - b) të ketë vendbanim dhe vendqëndrim të përhershëm në Shqipëri;
 - c) të ketë Figurë të Pastër Morale;

- d) të ketë arsim të lartë universitar (për përfaqësuesin e sportistëve ky është një kriter i dëshirueshëm por jo ndalues);
 - e) të ketë dhënë kontribut në zhvillimin e sportit dhe të ketë njohuri për Lëvizjen Olimpike;
 - f) të mos jetë në kushtet e konfliktit të interesave në postin e anëtarit të KE-së; dhe
 - g) të jetë më pak se 70 vjeç në momentin e kandidimit.
6. Anëtarët e KE-së do të ishte e dëshirueshme që të plotësonin dhe kushtet e mëposhtme:
- a) të kenë njohuri të mira të paktën të një prej gjuhëve zyrtare të KON-it (anglisht ose frëngjisht);
 - b) të kenë arsim të lartë universitar apo pasuniversitar në fushën e drejtësisë, ekonomisë, financës, administrimit apo sportit.
7. Anëtarët e KON-it nga Shqipëria, të zgjedhur sipas parashikimeve të KO, janë automatikisht anëtarë *ex-officio* të KE-së me të drejtë vote.
8. Anëtarët e Komitetit Ekzekutiv të KOKSH-it nuk duhet të marrin shpërblim për pjesëmarrje në mbledhjet e KE-së.
9. Rimbursimi i shpenzimeve administrative është i detyrueshëm për sa kohë ato janë brenda kufijve të përcaktuar nga Rregullorja e Brendshme. Gjithsesi, ato do të jenë objekt verifikimi të KE-së dhe të auditorit, si dhe do të paraqiten si pjesë e raportit financiar që aprovohet nga AP vjetore.
10. Mbledhjet e KE-së thirren nga Presidenti ose me kërkesën e 1/3 së anëtarëve të KE-së dhe njoftimet për datën, orën, vendin e mbledhjes dhe rendin e ditës bëhen, të paktën, 5 ditë përpara. Në mungesë të Presidentit mbledhjet e KE-së thirren nga Zv. Presidenti. Mbledhjet e KE-së mund të zhvillohen edhe në mënyrë elektronike. Përdorimi i mjeteve elektronike, për t'u mundësuar anëtarëve marrjen pjesë në mbledhjen e KE-së, bëhet me kusht që të merren masat teknike, të nevojshme për të garantuar identifikimin e tyre dhe sigurinë e komunikimeve elektronike, deri në atë masë që ky përdorim të jetë proporcional me arritjen e këtyre qëllimeve. Mjetet elektronike duhet të përfshijnë, por pa u kufizuar në to, kapacitetin për:
- a) transmetimin e mbledhjes së KE-së në kohë reale;
 - b) komunikimin e ndërsjellë, i cili u mundëson anëtarëve të shprehen në mbledhjen e KE-së në kohë reale, nga një vendndodhje tjetër;
 - c) mekanizma që mundësojnë procesin e votimit, përpara apo gjatë mbajtjes së mbledhjes së KE-së, pa qenë nevoja të caktohet një përfaqësues i autorizuar për të marrë pjesë fizikisht në mbledhje.
11. Për raste kur kërkohet vendimarrje e shpejte nga Komiteti Ekzekutiv, me propozim të Presidentit, Komiteti Ekzekutiv mund të aplikojë marrjen e Vendimeve Qarkulluese, duke ushtruar të drejtën e votës të shprehur me shkrim nga secili anëtar i Komiteti Ekzekutiv, brenda një afati të arsyeshëm dhe të qartë.
12. KE mbledhet, të paktën, një herë në 3 muaj. Ai merr vendime të vlefshme vetëm nëse më shumë se 1/2 e anëtarëve janë të pranishëm.

13. Vendimet në mbledhjet e KE-së merren me shumicë votash të anëtarëve të pranishëm. Në rast barazimi, vota e Presidentit është vendimtare. Votimi në mbledhjet vendimmarrëse të KE-së si rregull bëhet i hapur, por mund të bëhet i fshehtë, nëse një anëtar do ta kërkojë këtë.
14. Brenda tri ditëve nga përfundimi i mbledhjes së KE-së, Sekretari i Përgjithshëm i KOKSH-it (apo stafi i KOKSH-it) duhet t'u dërgojë anëtarëve të KOKSH-it vendimet e KE-së në mënyrë elektronike dhe t'i publikojë ato në faqen e internetit të KOKSH-it.
15. Në rast se një nga anëtarët e KE-së ka një interes të drejtpërdrejtë apo të tërthortë në çështjen për të cilën KE po merr një vendim, ai anëtar nuk mund të ushtrojë të drejtën e votës për atë çështje, dhe kuorumi do të llogaritet pa përfshirë praninë e tij.
16. Kur një anëtar i KE-së nuk përmbush detyrat e tij, vepron në kundërshtim me, apo shkelje të, Legjislacionit Shqiptar, shkel KO, shkel Statutin apo Rregulloren e Brendshme të KOKSH-it, ose nuk respekton apo nuk zbaton vendimet e organeve të KOKSH-it, ai iu nënshtrohet masave dhe sanksioneve të mëposhtme (në varësi të rëndësisë së fakteve dhe shkallës së dëmit apo shkeljes):
 - a) Paralajmërim
 - b) Vërejtje me shkrim
 - c) Shkarkim
17. Masat ndaj secilit prej anëtarëve të KE-së mund të aprovohen vetëm me 2/3 e votave të të gjithë anëtarëve të KE-së. Në rastin e shkarkimit, vendimi i 2/3 të KE-së duhet të aprovohet nga Asambleja e Përgjithshme me të njëjtën procedurë, kuorum dhe shumicë votash me të cilën është aprovuar zgjedhja e anëtarit të KE-së. Anëtar i propozuar nga KE për shkarkim do të konsiderohet i pezulluar dhe nuk mund të marrë pjesë apo të votojë në mbledhjet e KE-së, derisa AP e radhës të ketë marrë një vendim në lidhje me shkarkimin e tij. Në rastin kur masa merret ndaj Presidentit apo Zv. Presidentit, brenda 45 ditëve nga marrja e masës KE duhet të thërrasë një AP të Jashtëzakonshme që ka në rend dite shqyrtimin dhe ratifikimin ose jo të masës.
18. Anëtarët e KE që janë shkarkuar për shkaqet e parashikuara në nenin 21.16.c ose nëpërmjet një mocioni mosbesimi, nuk lejohen të kandidojnë për një periudhë prej 4 vjetësh nga momenti i shkarkimit, përveç nëse vendoset ndryshe nga Asambleja e Përgjithshme.
19. Anëtarët e KE-së që do të mungojnë pa asnjë arsye me shkrim të dërguar paraprakisht me postë dhe/ose e-mail te Presidenti dhe Sekretari i Përgjithshëm në 3 mbledhje rresht ose 6 mbledhje në vit, do të konsiderohen të përjashtuar, pa pasur nevojë të bëhet një Asamble e Përgjithshme për këtë qëllim. Kjo nuk aplikohet kur mungesa është bërë për arsye shëndetësore apo të tjera, që e kanë bërë absolutisht të pamundur njoftimin nga ana e anëtarit në fjalë.
20. Vendet e mbetura vakant në KE për çdo arsye do të plotësohen nga KE me individët që kanë marrë numrin më të lartë të votave, sipas renditjes së votave në listën e kandidatëve të Asamblesë Zgjedhore më të fundit. Anëtarët e KE-së që mbushin vendet vakante i ushtrojnë këto funksione deri në AP të radhës, kur AP miraton zëvendësimin apo zgjedh në mënyrë të rregullt një kandidat tjetër me të njëjtin kuorum dhe shumicë votash siç përcaktohet te Neni 17 (Asambleja Zgjedhore).



Neni 22 Presidenti

1. Presidenti zgjidhet nga Asambleja e Përgjithshme, me votim të fshehtë me më shumë se 50% të votave të të gjithë anëtarëve me të drejtë vote në përputhje me paragrafin e) të Neni 17 (*Asambleja Përgjithshme Zgjedhore*). Presidenti zgjidhet për një periudhë 4-vjeçare, dhe jo më shumë se 3 herë (gjithsej 12 vjet). Pasi ka përfunduar mandatin, Presidenti nuk mund të zgjidhet si anëtar i KE-së apo në ndonjë funksion tjetër drejtues të KOKSH.
2. Detyra e Presidentit është e papajtueshme me atë të Presidentit, Sekretarit të Përgjithshëm apo Financierit të anëtarit të KOKSH-it, që ai mund të përfaqësojë përpara zgjedhjes.
3. Presidenti ka këto detyra dhe kompetenca:
 - a) drejton veprimtarinë e KOKSH-it në përputhje me vendimet e Asamblesë së Përgjithshme dhe të Komitetit Ekzekutiv, dhe në masën që nuk bie ndesh me detyrat dhe kompetencat e ndonjë organi tjetër në këtë Statut;
 - b) kujdeset për zbatimin e vendimeve të Asamblesë së Përgjithshme dhe të Komitetit Ekzekutiv;
 - c) thërret dhe drejton mbledhjet e Komitetit Ekzekutiv;
 - d) përfaqëson KOKSH-in në të gjitha instancat kombëtare dhe ndërkombëtare;
 - e) përfaqëson KOKSH-in në të gjitha aktivitetet e tij, dhe në marrëdhëniet me të tretët;
 - f) mund të delegojë kompetenca në mungesë dhe me porosi për Zv. Presidentin, sipas çdo rasti të gjykuar prej tij;
 - g) nënshkruan së bashku me Sekretarin e Përgjithshëm dokumentet financiare për vlerate përcaktuara në Rregulloren e Brendshme;
 - h) është përfaqësues dhe zëdhënës i opinionit të përbashkët të Komitetit Ekzekutiv dhe është ai që del në konferenca për shtyp dhe bën të ditur në media qëndrimet e Komitetit Ekzekutiv;
 - i) formon dhe thërret grupe pune dhe komitete të përkohshme në raste nevojë, pasi KE ka dhënë miratimin;
 - j) kryeson delegacionin e KOKSH-it në Lojërat Olimpike, Evropiane dhe Mesdhetare dhe ngjarje të tjera shumë sportëshe;
 - k) kryen çdo detyrë tjetër që përcaktohet në Rregulloren e Brendshme të KOKSH-it, në këtë Statut dhe në Legjislacionin Shqiptar, apo që mund t'i ngarkohet nga AP dhe KE.
4. Kandidati për President duhet të plotësojë, të paktën, kriteret e mëposhtme në mënyrë kumulative:

Kriteret për tu zgjedhur dhe ushtruar postin e Presidentit janë:

 - a) të jetë shtetas i Republikës së Shqipërisë;
 - b) të ketë vendbanim dhe vendqëndrim të përhershëm në Shqipëri;
 - c) të ketë Figurë të Pastër Morale;
 - d) të ketë arsim të lartë universitar;



- e) të ketë dhënë kontribut në zhvillimin e sportit dhe të ketë njohuri për Lëvizjen Olimpike;
- f) të mos jetë në kushtet e konfliktit të interesave në postin e Presidentit;
- g) të ketë njohuri shumë të mira të paktën të një prej gjuhëve zyrtare të KON-it (anglisht ose frëngjisht); dhe;
- h) të jetë më pak se 70 vjeç në momentin e kandidimit.

Neni 23 Zv.Presidenti

1. Zv.Presidenti zgjidhet nga Asambleja e Përgjithshme me votim të fshehtë me më shumë se 50% të votave të të gjithë anëtarëve me të drejtë vote në përputhje me paragrafin e) të Neni 17 (Asambleja Përgjithshme Zgjedhore). Ai zgjidhet për një periudhë 4-vjeçare, dhe jo më shumë se 3 herë (gjithsej 12 vjet).
2. Zv.Presidenti zëvendëson Presidentin gjatë mungesës së këtij të fundit, me autorizim nga Presidenti.
3. Kriteret që duhet të plotësojë një kandidat për Zv.President janë të njëjtat kritere me ato të kandidatëve për President.

Neni 24 Mbajtësi i Thesarit

Mbajtës Thesari do të zgjidhet një nga anëtarët e KE-së, me propozim të Presidentit dhe votim në Komitet Ekzekutiv. Mbajtësi i Thesarit do të jetë njëkohësisht edhe kryetari i Komisionit Financë-Marketing.

Neni 25 Sekretari i Përgjithshëm

1. Sekretari i Përgjithshëm propozohet nga Presidenti dhe emërohet me shumicën e votave nga të gjithë anëtarët e Komiteti Ekzekutiv.
2. Sekretari i Përgjithshëm drejton dhe organizon të gjithë veprimtarinë administrative të KOKSH-it. Merr pjesë në mbledhjet e Komitetit Ekzekutiv, por pa të drejtë vote.
3. Detyrat dhe kompetencat e Sekretarit të Përgjithshëm janë vetëm me natyrë administrative. Detyra me natyrë administrative nënkuptojnë detyrat e përditshme që kanë të bëjnë me funksionimin e administratës së KOKSH-it dhe që i vijnë në ndihmë vullnetit të Asamblesë së Përgjithshme dhe Komitetit Ekzekutiv.
4. Struktura Organizative e punonjësve të KOKSH-it, numri i tyre dhe niveli i pagave do të miratohen nga KE.
5. Sekretari i Përgjithshëm nuk mund të ushtrojë me nismën e tij detyra dhe kompetenca me natyrë ekzekutive, financiare, sportive apo përfaqësimi dhe nuk bën aprovimin e projekteve apo politikave të tjera sportive në emër të KOKSH-it, përveç rastit të zbatimit të vendimeve të KE-së dhe orientimeve me shkrim të Presidentit, apo kur Asambleja e Përgjithshme vendos ndryshe.



6. Përveç kur Rregullorja e Brendshme vendos detyra të tjera shtesë në përputhje me parashikimet e paragrafit 5 më lart të këtij Neni 25, Sekretari i Përgjithshëm ka këto detyra dhe kompetenca:
- a) zbaton vendimet dhe detyrat e dhëna nga Asambleja, Komiteti Ekzekutiv dhe Presidenti;
 - b) organizon, menaxhon dhe do të jetë përgjegjës për detyrat e përditshme administrative të KOKSH-it;
 - c) siguron kushtet për punën e Asamblesë dhe të organeve të KOKSH-it si dhe implementimin e vendimeve të tyre;
 - d) drejton përgatitjen dhe materialet për mbledhjet e Asamblesë, për mbledhjet e Komitetit Ekzekutiv dhe Komisioneve të KOKSH-it;
 - e) është përgjegjës për ligjshmërinë e operacioneve dhe të veprimeve të KOKSH-it;
 - f) siguron transparencën e punës së KOKSH-it;
 - g) nënshkruan dokumente të natyrës administrative në emër të KOKSH-it dhe lëshon urdhra për pagesa brenda qëllimit të planit financiar të KOKSH-it, që mbulojnë përmbushjen e veprimeve të përditshme administrative të KOKSH-it, në vlerat e përcaktuara në Rregulloren e Brendshme;
 - h) nënshkruan së bashku me Presidentin dokumentet financiare për vlerat e përcaktuara në Rregulloren e Brendshme.
7. Kriteret që duhet të plotësojë një kandidat për Sekretar i Përgjithshëm janë:
- a) të jetë shtetas i Republikës së Shqipërisë;
 - b) të ketë vendbanim dhe vendqëndrim të përhershëm në Shqipëri;
 - c) të ketë Figurë të Pastër Morale;
 - d) Të ketë arsim të lartë universitar në fushën e sportit, drejtësisë, ekonomisë apo menaxhimit;
 - e) të ketë dhënë kontribut në zhvillimin e sportit dhe të ketë njohuri për Lëvizjen Olimpikë;
 - f) të mos jetë në kushtet e konfliktit të interesave në postin e Sekretarit të Përgjithshëm; dhe
 - g) të ketë njohuri shumë të mira të paktën të një prej gjuhëve zyrtare të KON-it (anglisht ose frëngjisht).
8. Sekretari i Përgjithshëm është i punësuar i KOKSH-it sipas dispozitave të Kodit të Punës me një kontratë pune me afat të pacaktuar. Ai mund të shkarkohet nga detyra sipas dispozitave përkatëse të Kodit të Punës. Organi vendimmarrës për shkarkimin nga detyra të Sekretarit të përgjithshëm është KE, me shumicën e votave të të gjithë anëtarëve të tij.

Neni 26 Komisioni i Verifikimeve dhe i Etikës

1. Anëtarët e KVE-së zgjidhen nga Asambleja e Përgjithshme me votim të fshehtë me më shumë se 50% të votave të të gjithë anëtarëve me të drejtë vote në përputhje me paragrafin e) të Neni 17 (*Asambleja Përgjithshme Zgjedhore*). Ata zgjidhen për një periudhë jo më të gjatë se 7-vjeçare, me të drejtë rizgjedhje deri në një herë.
2. KVE do të përbëhet nga 3 anëtarë, Kryetari i KVE zgjidhet nga Asambleja e Përgjithshme me votim të fshehtë me më shumë se 50% të votave të të gjithë anëtarëve me të drejtë vote në përputhje me paragrafin f) të Nenit 17 (*Asambleja Përgjithshme Zgjedhore*). Kandidatët e KVE-së do të propozohen nga anëtarët me të drejtë vote të Asamblesë së Përgjithshme, dhe duhet të jenë persona që nuk janë anëtarë në Organizatat Sportive anëtare në KOKSH.
3. Kompetencat e KVE-së do të jenë:
 - a) të sigurohet në çdo mbledhje të Asamblesë së Përgjithshme për legjitimitetin e anëtarëve të KOKSH-it (me të drejtë vote ose jo);
 - b) të sigurohet për plotësimin e kriterëve të nevojshme të kandidatëve për anëtarë të KOKSH-it apo për kandidatët për pozicione të ndryshme në organet e KOKSH-it;
 - c) identifikimin dhe mandatimin e personave të autorizuar për të votuar në emër e për llogari të një Organizate Sportive me të drejtë vote apo identitetin e pjesëmarrësve të tjerë në Asamblenë e Përgjithshme;
 - d) të sigurohet që çdo vendim i marrë nga Asambleja e Përgjithshme është në përputhje me kuorumin dhe shumicën e kërkuar nga Statuti i KOKSH-it;
 - e) të raportojë në KE dhe/ose në Asamblenë e Përgjithshme në rast se një anëtar i KOKSH-it apo funksionar i KOKSH-it ndodhet në situatë papajtueshmërie me pozicionin e tij në KOKSH;
 - f) të sigurohet që anëtarët e KOKSH-it janë vazhdimisht në përputhje me kriteret e Statutit;
 - g) të udhëheqë dhe certifikojë proceset zgjedhore të Asamblesë Zgjedhore;
 - h) të sigurohet që anëtarët dhe organet e KOKSH-it ushtrojnë veprimtarinë e tyre brenda KOKSH-it në përputhje me Kodin e Etikës të KOKSH-it dhe Legjislacionin Shqiptar.
4. Kandidatët për anëtarë të KVE-së duhet të plotësojnë këto kushte:
 - a) të jenë shtetas të Republikës së Shqipërisë;
 - b) të kenë vendbanim dhe vendqëndrimtë përhershëm në Shqipëri;
 - c) të kenë arsim të lartë universitar në fushën jurisprudencës;
 - d) të kenë Figurë të Pastër Morale;
 - e) të mos jenë në kushtet e konfliktit të interesave me funksionin e anëtarit të KVE-së; dhe
 - f) të mos jenë kandidatë për, apo drejtues të (President apo Sekretar i Përgjithshëm) ndonjë Organizate Sportive, anëtarë të KOKSH-it apo të organeve dhe/ose komisioneve të tjera të KOKSH-it.
5. Kandidatët për Kryetar të KVE, përveç kushteve të përcaktuara në pikën 5 të këtij neni duhet të përmbushin edhe kushtet e mëposhtme:



- a) të kenë njohuri shumë të mira të paktën të një prej gjuhëve zyrtare të KON-it (Anglisht ose Frëngjisht);
 - b) të jenë më pak se 70 vjeç në momentin e kandidimit;
 - c) të kenë njohuri të LO;
 - d) të kenë përvojë në sport;
 - e) të kenë mbi 5 vite eksperiencë në fushën e jurisprudencës;
 - f) të kenë patur eksperiencë të mëparshme në Borde Drejtuese apo Borde Ekzekutive të Organizatave Jofitimprurëse.
6. Në rast të lënies vakant të njërit nga pozicionet në KVE, ai do të plotësohet me zgjedhje në mënyrë të rregullt nga një kandidat tjetër me të njëjtin kuorum dhe shumicë votash siç përcaktohet në NENI 17 (Asambleja Zgjedhore), në Asamblenë e Përgjithshme të radhës.
 7. Anëtarët e KVE që janë shkarkuar për shkaqet e parashikuara në këtë statut ose nëpërmjet një mocioni mosbesimi, nuk lejohen të kandidojnë për një periudhë prej 4 vjetësh nga momenti i shkarkimit.
 8. KVE merr vendimet e tij me shumicë votash.
 9. KE është përgjegjës të verifikojë nëse kandidatët e propozuar për KVE nga anëtarët e KOKSH-it përmbushin kriteret e mësipërme.

Neni 27 Ndalimi i konfliktit të interesave

1. Në përputhje me legjislacionin për organizatat jofitimprurëse, çdo anëtar i Asamblesë ose KE-së duhet të tërhiqet nga shqyrtimi dhe marrja e vendimit për çdo çështje që ai ose familjarët e tij kanë interesa të drejtpërdrejtë ose të tërthortë vetjakë.
2. Çdo transaksion financiar për llogari të KOKSH-it, ndërmjet një anëtari të organit vendimmarrës, atij ekzekutiv, a një punonjësi të KOKSH-it, si dhe një personi tjetër juridik dhe fizik, kur anëtari i organit vendimmarrës, atij ekzekutiv ose punonjësi i organizatës jofitimprurëse ka interes financiar, mund të përfundohet vetëm nëse Asambleja e lejon atë dhe nëse ky transaksion përmban kushte më të favorshme për KOKSH-in.
3. Punonjësit e paguar në administratën e KOKSH-it nuk mund të jenë anëtarë të Asamblesë së KOKSH-it. Ata mund të marrin pjesë në mbledhjet e tyre pa të drejtë vote.
4. Nëse ka kundërshti nëse një anëtar i AP-së apo KE-së është ose jo në konflikt interesi, kjo i përcillet për vendimmarrje KVE-së. Nëse ka kundërshti nëse një anëtar i KVE-së është ose jo në konflikt interesi, kjo i përcillet për vendimmarrje KE-së.

Neni 28 Mbledhjet në Kushtet e Forcës Madhore

1. Për qëllimet e këtij Statuti, “**Forcë Madhore**” do të thotë çdo akt, ngjarje, veprim ose mosveprim që (i) është e paparashikueshme; (ii) është jashtë kontrollit të palës që e pretendon forcën madhore dhe nuk është shkaktuar për faj të saj; (iii) ka ndikim direkt mbi palën që e pretendon forcën madhore; dhe (iv) bën të pamundur përmbushjen e detyrimit nga ana e palës që pretendon forcën madhore. Në përdorimin e këtushëm, për ilustrim forca madhore mund të përfshijë pa kufizime, ngjarje natyrore, tërmete, zjarre, përmytje, luftëra,

- trazira civile ose ushtarake, akte terrorizmi, sabotime, greva, epidemi, pandemi, trazira, ndërprerje të energjisë elektrike, dështime kompjuterike dhe rrethana të tjera të cilat mund të shkaktojnë ndërprerje, humbje ose mosfunksionim të shërbimeve të furnizimit me energji elektrike, kompjuterike (pajisjeve ose softuerit) ose të shërbimit të komunikimit telefonik, aksidente, akte të autoriteteve civile ose ushtarake, apo marrjen e masave të jashtëzakonshme nga shteti sipas Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.
2. Për sa kohë që nuk bie ndesh me përmbajtjen e këtij Statuti në rastet e Forcës Madhore, KE mund të përcaktojë që mbledhjet e organeve të parashikuara në këtë Statut, mund të mbahen tërësisht me anë të mjeteve elektronike ose formave të tjera të komunikimit, që lejojnë numrin maksimal të pjesëmarrësve të komunikojnë në mënyrë adekuate me njëri-tjetrin gjatë takimit. KE do të vendosë procedurat për mbajtjen e këtyre mbledhjeve, duke përfshirë, pa kufizim, procedurat për votim përmes mjeteve elektronike ose formave të tjera të komunikimit.
3. Në kushtet e Forcës Madhore ose situatave që nuk lejojnë prezencën fizike të anëtarëve të Asamblesë në AP, mbledhjet e AP-së mund të zhvillohen edhe në mënyrë elektronike. Përdorimi i mjeteve elektronike, për t'u mundësuar anëtarëve marrjen pjesë në mbledhjen e AP-së, kur ata e kanë të pamundur pjesëmarrjen fizike për arsye të sipërpërmendura, bëhet me kusht që të merren masat teknike, të nevojshme për të garantuar identifikimin e tyre dhe sigurinë e komunikimeve elektronike, deri në atë masë që ky përdorim të jetë proporcional me arritjen e këtyre qëllimeve. Mjetet elektronike duhet të përfshijnë, pa kufizim, kapacitetin për:
- a) transmetimin e mbledhjes së AP-së në kohë reale;
 - b) komunikimin e ndërsjellë, i cili u mundëson anëtarëve të shprehen në mbledhjen e AP-së në kohë reale, nga një vendndodhje tjetër;
 - c) identifikimin e anëtarëve në përputhje me legjislacionin shqiptar;
 - d) mekanizma që mundësojnë procesin e votimit, dhe fshehtësinë e votes.

KREU VI TË NDRYSHME

Neni 29 Burimet e financimit

Të ardhurat vjetore të KOKSH-itsigurohen nga:

- a) subvencionet në formën e grantit nga ana e shtetit shqiptar;
- b) subvencionet nga KON/Solidariteti Olimpik si dhe organizata sportive ndërkombëtare të tjera;
- c) kuotizacionet e anëtarëve të KOKSH-it;
- d) çdo burim tjetër i ligjshëm.

Neni 30 Statuti dhe Rregullorja e Brendshme e KOKSH-it



1. Statuti i KOKSH-it duhet gjithmonë të jetë në përputhje me Legjislacionit Shqiptar dhe KO dhe t'i referohet shprehimisht kësaj të fundit.
2. Nëse ka ndonjë dyshim përse i takon implikimit ose interpretimit të Statutit të KOKSH-it, ose nëse ekziston ndonjë kontradiktë midis Statutit të KOKSH-it dhe KO, kjo e fundit ka përparësi.
3. Rregullorja e Brendshme e KOKSH-it miratohet apo ndryshohet nga Komiteti Ekzekutiv me 2/3 e votave të të gjithë anëtarëve të tij.

Neni 31 Ndryshimet e Statutit

1. Ndryshimet e Statutit mund të propozohen nga anëtarët apo KE-ja dhe mund të bëhen vetëm nga Asambleja e Përgjithshme në përputhje me paragrafin 17 te Neni 16 (*Asambleja e Përgjithshme*).
2. Propozimet për ndryshimet në statut duhet t'u jenë dërguar anëtarëve të Asamblesë, të paktën, 30 ditë përpara.
3. Çdo ndryshim që mund të bëhet në Statutin e KOKSH-it, duhet të miratohet nga KON dhe ministri përgjegjës për sportin.

Neni 32 Akademia Olimpikë Shqiptare

Në strukturën e KOKSH-it funksionon Akademia Olimpikë Shqiptare, që subvencionohet nga buxheti i KOKSH-it, veprimtaria e së cilës rregullohet me Rregulloren e saj të Brendshme.

Neni 33 Këshilli i Arbitrazhit Sportiv.

1. Pranë KOKSH vepron, si organ i pavarur këshillimi dhe arbitrimi, Këshilli i Arbitrazhit Sportiv ("KAS"), i cili funksionon në bazë dhe në zbatim të rregullores së KAS-it të miratuar nga Asambleja e Përgjithshme, e cila duhet të miratohet ose ndryshohet në përputhje me paragrafin 17 te Neni 16 (*Asambleja e Përgjithshme*).
2. Çdo mosmarrëveshje që është e lidhur me sportin brenda territorit të Republikës së Shqipërisë duhet t'i drejtohet ekskluzivisht Këshillit të Arbitrazhit Sportiv në përputhje me Legjislacionin Shqiptar dhe me rregulloren e KAS-it.
3. Çdo mosmarrëveshje që mund të lindë mes anëtarëve dhe/ose organeve të KOKSH-it duhet t'i drejtohet ekskluzivisht Këshillit të Arbitrazhit Sportiv në përputhje me Legjislacionin Shqiptar dhe me rregulloren e KAS-it.
4. Vendimet e KAS-it mund të ankimohen vetëm në Gjykatën e Arbitrazhit Sportiv në Lozanë, Zvicër, vendimi i së cilës është përfundimtar dhe i formës së prerë, konform Kodit të Sporteve të këtij Arbitrazhi.

Neni 34 Baza ligjore

Ky statut është hartuar në përputhje me KO dhe Legjislacionin Shqiptar në fuqi.




STATUTI I KOMITETIT OLIMPIK KOMBËTAR SHQIPTAR

Miratuar nga Asambleja e Përgjithshme, në datë 2 Dhjetor 2023 në Tiranë.

President

Z. Fidel YLLI



Sekretar i Përgjithshëm

Z. Gerti SHIMA

